



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.94/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Hasan Shala kryesues, Fejzullah Rexhepi dhe Adnan Konushevcu anëtarë, si dhe me pjesmarrjen e zyrtarit ligjor Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) dega në Mitrovicë, për shkak të vendosjes së banerit të kandidatit për kryetar të Komunës në Mitrovicë, për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me datë 03.10.2017, mori këtë:

V E N D I M

HIDHET si e palejuar ankesa e subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) dega në Mitrovicë, lidhur me pretendimet sa i përket vendosjes së posterëve mbi rrugë publike të Agim Bahtirit kandidat për Kryetar të Komunës në Mitrovicë, pasi që lidhur me këto pretendime është vendosur me vendimin ZL. Anr.59/2017 të dates 26.09.2017.

A r s y e t i m

PZAP-i ka pranuar një ankesë me datën 29.09.2017 dhe po ashtu të njëjtën përmes dërgesës postare e ka pranuar me datën 24.09.2017 nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) me të cilën pretendon se me datën 24.09.2017 në disa rrugë kryesore të qytetit të Mitrovicës, janë vendosur pllakatat e kandidatit për Kryetar të Kuvendit Komunal. Me këtë rast sipas pretendimit në ankesë thekson se subjekti politik PDK ka bërë shkelje të dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) e LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur *gjashtë* (6) fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 30.09.2017, subjekti politik Aleanca Kosova e Re (AKR), thekson se lidhur me vendosjen e materialit zgjedhor, pra të pllakatave të kandidatit për kryetar të Kuvendit të Komunës së Mitrovicës, në disa pjesë të qytetit, pra të njëjtat pllakata i kemi tërhequr. Më tutje ka shtuar se, pasi që e kemi pranuar ankesën kemi dalë në terren dhe e kemi larguar panon e vendosur në vendin e pa lejuar dhe të njëjtat veprime nuk janë përsëritur . Po ashtu PZAP-in e ka njoftuar se vendosja e pllakatave ishte bërë pa miratimin e strukturave partiake të subjektit politik AKR, duke i larguar me kohë të njëjtat pano nga përgjegjësit e fushatës zgjedhore. Më tutje ka theksuar se, subjekti politik AKR është i përkushtuar të respektoj ligjin dhe rregullat zgjedhore të KQZ-së, që e përcaktojnë zhvillimin dhe organizimin e fushatës zgjedhore.

Përgjigjes në ankesë, si dëshmi i ka bashkangjitur *pesë* (5) fotografi me të cilat shihet se është larguar posterit nga vendi ku kanë qenë të vendosura.

Paneli, pasi që vlerësoj ankesën konstatoj se:

Ankesa është e pa lejuar

Paneli lidhur me shqyrtimin e ankesës së ankuesit ka vlerësuar se ankesa është e palejuar, sepse lidhur me pretendimet ankimore se subjekti politik AKR ka vendosur pllakatat e kandidatit për Kryetar të Komunës Agim Bahtiri, në disa rrugë kryesore, mbi rrugë publike, të qytetit të Mitrovicës, konstatoi se ankesa e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), ka njëjtësi të natyrës objektive ankimore, pasi që për të njëjtën çështje tani është e vendosur në mënyrë meritore me vendimin ZL.Anr. 59/2017 e datës 26.09.2017.

Nga kjo gjendje e vërtetuar faktike, rezulton se kjo çështje në fjalë është çështje e gjykuar (res iudicata).

Paneli në kuptim të nenit 120.1, pika c), dhe nenit 118.1, të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Zl.Anr. 94/2017 më datën 03.10.2017.



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.